



PROCESVERBAL IX /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9 (nëntë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	26.09.2025

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Z.Vullnet Luzhnica	Të pranishëm tjerë:
Z.Selman Kolgeci	Z.Edon Sadikaj	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyçi	Znj.Saranda Bajraktari	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Znj.Mimoza Bajraktari	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Znj.Festë Kabashi	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Dardan Berisha	Z.Xheladin Sadikaj
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Xhevshet Gashi	Znj. Afërdita Morina	
Znj.Sanie Kuçi- Rexhepaj	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Liridon Fandaj	
Z. Lirim Qatani	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Aziz Bytyqi	Z. Reshat Selimaj	
Znj.Fidaije Kukaj	Z.Herolind Limaj	
	Znj.Jehona Lumi	
	Rrafshi	

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të komunës së Suharekës për vitin 2026;
3. Shqyrtimi i raportit të punës për periudhën 2022-2025;
4. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të komunës së Suharekës për vitin 2026;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - sot kemi një dokument që nuk është buxhet i qytetarëve.Është një dokument i hartuar pa transparencë dhe pa një bashkëpunim institucional.Ky buxhet nuk ka kaluar në KPF i cili është organi i vetëm për shqyrtimin e këtij buxheti. Andaj mendoj që kjo është një fyerje e hapur për Kuvendin Komunal dhe për qytetarët që ne përfaqësojmë.Arsyeja e dytë pse ne si grup parlamentar i LDK-së jemi kundër është se shpërndarja e investimeve kapitale.Janë shumë projekte këtu të cilat janë të përfunduara.Arsyeja e tretë është se ekzekutivi vazhdon me planifiku të hyra nga taksa në aktivitet për biznese.Ju këtu jeni zotu që keni me hek taksën në aktivitet për biznese dhe nuk e keni bërë.Andaj konsideroj që ky buxhet nuk është buxhet i qytetarëve dhe ne si grup parlamentar do të votojmë kundër.

Kryetari - falemnderoj të gjithë për punën dhe bashkëpunimin që kemi pas për 4 vite.

Buxheti është shumë me rëndësi me kalu.

Urim Suka - Çasja e Kryetarit që sapo bëri,e tregon jo seriozitetin e tij në trajtimin e një prej dokumenteve më të rëndësishme që ky kuvend merr.Ai është dasht me qëndru këtu dhe me i ndëgju të gjitha vërejtjet që ne i kemi,dhe nëse i sheh të arsyeshme është dasht ti merr për bazë dhe ti adresoj. Vendimi për buxhetin është vendimi më i rëndësishëm që ky kuvend merr brenda një viti kalendarik. Si i tillë do të duhej të kishte edhe trajtimin sa më të mirë të secilit prej nesh.Ne si grup i Kuvendarëve e kemi analizuar dhe trajtuar këtë dokument në detaje dhe kemi ardhë në përfundimin që ky dokument ka fatin e 4 viteve të tjera që ju keni përgadit për këto 4 vite.Është tepër i keq,i papërgaditur,nuk mbron interesat qytetare, madje në këto dokumet nuk reflektojnë as ato premtime që ju vet po i bëni.Si të tillë ne e votojmë kundër dhe ftojmë secilin prej jush që të votoj kundër dhe ti japim mundësinë një qeverisje të re që pritët të instalohet me votën e qytetarëve pas 12 tetorit.Të ketë mundësinë që ta ndryshoj,ta miratoj duke reflektu në këtë dokument interesat qytetare e premtimet që i japin gjatë kësaj kohe.Më lejoni që me disa shembuj të argumentoj fjalën time se pse ky buxhet nuk duhet të miratohet.Në këtë buxhet për fshatin Budakovë për vitin 2026 janë të planifikuara ndërtimi i rrugëve: „Furra e UÇK-së „Ali Buqa dhe Sherif Buqa“,mirëpo unë këtu kam kontratën e vitit 2025 për fshtin Budakovë dhe këto tri rrugë figurojnë në kontratë për këtë vit.Pse duhet të figurojnë rrugët e njejta edhe në këtë buxhet deri sa ka një kontratë për këtë vit?Këto rrugë a do të shtrohen sipas kontratë për këtë vit apo do të shtrohen vitin tjetër sipas planifikimit që e keni sjell?Rruga „Kodra e Thatë“ në Budakovë figuron edhe në planifikimin për fshatin Bukosh.Këtë shqetësim e kam thënë edhe kur kemi diskutu për kornizën.Kjo rrugë nuk mund të jetë në dy fshatrat.Në fshatin Greiqec në këtë buxhet po

figuron ndërtimi i rrugës „Dy Martirët“-vazhdim.Unë këtu kam 5 kontrata ku figuron kjo rrugë për t’u shtruar.Kontrata e vitit 2020,kontrata e vitit 2021,2022,2023 dhe 2024.Nga gjithë këto kontrata është shtrur vetëm një pjesë e kësaj rruge dhe atë pas reagimeve të mia që i kam bërë në fillim të viti 2023. Në fshatin Nishor ju keni hartu një kontratë për këtë vit për t’u shtruar disa rrugë por disa nga ajo kontratë nuk janë shtruar.P.sh. rruga „Brija e Hisarit,Rasim Ramadani-vazhdim,Demaj-vazhdim, Tahir Ademi-vazhdim“,dhe këto rrugë nuk po figurojnë tash në planifikim edhe për vitin e ardhshëm. Askund nuk pash që keni planifiku mjete për ndërtimin e shkollës “7 Marsi“.Për 4 vite ka figuru në buxhet dhe asnjëherë asnjë lëvizje nuk është bërë për m’u ndërtu kjo shkollë ndërsa sot as nuk keni planifiku mjete për këtë buxhet e në debate po premtoni që keni me ndërtu.Në debate pash që Kryetari ndër tjera premtonte:stacioni i autobusëve,pishina olimpike,QMF,2 qerdhe,sallë sportive mirëpo ky vendim që po e analizojmë sot,përveq që projekton buxhetin për vitin 2026 është edhe kornizë buxhetore për vitet 2026-2028 dhe askund nuk figurojnë në planifikim këto projekte që po prezanton. Më lejoni ti adresoj disa çështje që lidhen me vendbanimin tim,fshatin Bllacë.Sa i përket hapësirës së varrezave në fshatin Bllacë,është e turpshme gjendja që është atje.Drejtori i Katastrës nuk ka as aparat për me i vendos pikat,përkundër kërkesave që i ka bërë këshilli i fshatit,përkundër që unë e kam ngrit si çështje.Ata me vetiniciativë i kanë vendos pikat dhe kanë fillu dhe e kanë rregullu pak atë hapësirë,mirëpo as në këtë buxhet nuk kemi mjete të ndara për atë hapësirë.Ju lus të reflektoni kush do që e ka mundësië që në këtë buxhet kjo çështje të adresohet.Disa rrugë nëpër Bllacë kanë mungesë të trotuareve dhe kjo mungesë e trotuareve nënkupton që fëmijët mund të rrezikohen nga aksidentet, sidomos te rruga që shkon për Malishevë e cila është shumë e frekuentuar.Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve,cilësia e punimeve ka qenë skandaloze ku shumica e punëve që janë bërë në Bllacë janë tepër të prishura dhe duhet me patjetër me planifiku një buxhet të madh që me fillim të vitit m’u trajtu këto probleme.Lagjja „Zekolli“ka katër vite që kanë probleme me kanalizim dhe në vazhdimsi nëpër Bllacë ka probleme me kanalizim.Keni premtu qerdhe por nuk figuron askund.Përkundër që në disa hapësira nëpër vendbanime tjera keni bërë investime në shtrat të lumit, në Bllacë nuk ju ka shku mendja me rregullu shtratin e lumit dhe problemet janë të mëdhaja.Disa lagje në fshat ende nuk kanë ujë të pijes dhe as në këtë buxhet nuk keni planifiku mjete për këtë çështje.Problemin e impianteve të ujërave të zeza në Bllacë i kam diskutu këtu dhe prap s’keni nda mjete për këtë pjesë.Mirëmbajtja e hapësirave publike,si çdo kund,fatin e njejtë e kanë edhe në Bllacë.Është për keqardhje.Unë thash vetëm disa probleme që janë në këtë buxhet por të tilla ka plot,andaj ju ftoj që të votojmë kundër.

Selman Kolgeci - ky projektion buxhetor nuk përfaqëson interesat e qytetarëve të Suharekës.Ky nuk është një buxhet i ndërtun mbi prioritete dhe nevojat reale të qytetarëve por mbi kalkulime politike dhe ndarje selektive të mjeteve.E kemi pa tashmë për vite me radhë se edhe kur buxheti kalon dhe vendimet merren në Asamble,Kryetari nuk i respekton ato vendime,përkundrazi ai i devijon,i shtrembëron dhe i tjetëron sipas dëshirës së tij.Kjo do të thotë se vullneti i asambleistëve po shkelet hapur.Për këtë ka folur qartë edhe raporti i auditorit i cili ka konstatuar parregullsi serioze në menaxhimin e financave publike dhe mënyrën se si po shfrytëzohen mjetet e buxhetit komunal.Ky buxhet nuk jep zgjidhje për problemet e përditshme të qytetarëve tanë,as për grupet që përsëriten çdo vit pa u realizu,as për infrastrukturë,as për ujin e pijes,as për varreza të reja që kanë nevojë urgjente në shumë fshatra,as për investima tjera të nevojshme për qytetarët.Ky është një buxhet me shuma fikse, premtime të recikluara dhe projekte të lëna përgjysmë.Ne nuk jemi kundër zhvillimit, përkundrazi kërkojmë një buxhet që ti shërbej zhvillimit,transparencës dhe qytetarëve por ky dokument që e kemi përpara nuk e bën këtë.Andaj ky projekt-buxhet duhet të rishikohet nga fillimi dhe me reflektu nevojat e vërteta të njerëzve tonë dhe të jetë në funksion të mirëqenies së qytetarëve tonë dhe jo në funksion të mirëmbajtjes së pushtetit dhe interesave të ngushta politike.Meqenëse jemi në një vit zgjedhor,unë besoj që qytetarët e Suharekës do të zgjedhin një Kryetar të ri nga radhët tona dhe ne jemi gati me marrë përgjegjësi të reja dhe me tregu se buxheti duhet me u bërë ndryshe për qytetarin.Tek çështja fjalës paraprahe të Kryetarit që na falemderoi për bashkëpunim,një gjë të tillë unë nuk mund ta bëj për të sepse ka qenë Kryetari më jobashkëpunues që e kemi njoft.I kemi qu shkresa njëqind herë,kemi ngrit çështje njëqindëherë herë këtu dhe as nuk është përgjigj në kërkesë për çasje të dokumenteve zyrtare që e ka obligim ligjor dhe as nuk i ka marrë vendimet e Asamblesë si të mirëqena por ka bërë çka ka dasht.

Doruntina Zenelaj - i mbështes parafolësit e mi dhe mendoj që ky buxhet nuk duhet të miratohet.Në fshatin Savrovë ju keni paraparë të shtrohet rruga“Pllava“ por pasi unë ja rritur në këtë fshat dhe në bazë të hulumtimeve që kam bërë,kjo rrugë nuk ekziston fare.A mund të ma gjeni kjo rrugë ku është?

Liridon Fandaj - unë kam prit që Drejtori i Ekonomisë dhe Financave ta prezantoj buxhetin e pastaj të diskutojmë por në bazë të takimeve që kemi pas më herët drejtori është deklaruar që ka qenë në komision për dëgjime publike por kur është bërë ky buxhet nuk e kanë ftuar askush dhe këto projekte kapitale i ka bërë Kryeyari e tash ai na flet neve për bashkëpunim. Prej KAB-it e deri te përfundimi i buxhetit ne ju kemi ofruar bashkëpunim dhe ti fusim ato projekte që janë prioritet për qytetarët por jo prioritetet e Kryetarit dhe të militantëve të tij. Ky buxhet nuk është i qytetarëve por është i Kryetarit dhe i militantëve të tij.

Kryesuesi - unë si Kryesues ju kam thirr me datë 5 shtator. I kam thirr shefat e grupeve parlamentare në një takim dhe me diskutu dhe ne në fakt e kemi mbajtur atë takim pa prezencën e LDK-së.

Liridon Fandaj - është e vërtetë që na ke thirr për bashkëpunim por unë e kam dhënë një propozim që 4 vite për ujin në Peqan dhe asnjëherë se keni marrë parasysh. Në atë takim, cilat prej atyre propozimeve që janë propozu janë inkorporu në buxhet?

Laureta Tafaj - unë e pata fjalimin tim me Kryetarin por ai shkoj dhe ishalla nuk kthehet më në këtë Kuvend.

Aziz Bytyqi - unë mendoj që disa projekte që janë parapa për këtë vit dhe që nuk janë realizu, të paktën të jenë prioritet për vitin tjetër. Në këtë kontekst unë i kam disa propozime të cilat kërkoj të inkorporohen në projekt-buxhet dhe njëra ndër to është segment në rrugën „Bubullima“ në Suharekë, „rruga „Ilaz Berisha“-vazhdim, në Sopijë ku e keni parapa investimin në komunë për kanalizim, unë kam bërë një vizitë dhe kam pa që në Sopijë 5 familje nuk mund të vendosen në shtëpitë e tyre për shkak të mungesës së kanalizimit dhe kërkoj të bëhen investime edhe në fshatin Sopijë. Në Nishor kërkoj që rruga „Rasim Ramadani“ e cila ka qenë e paraparë për këtë vit, kërkoj që të jetë prioritet e para për këtë vit dhe rruga „Sejdakët“-vazhdim.

Saranda Bajraktari - kam dy rekomandime për dy rrugica: degëzim në rrugën „Liman Rexhepi“ në Bukosh 100m dhe degëzim në rrugën „Ismet Jashari“ në Javor 80m.

Armend Krasniqi - gjërat që i keni dëgjuar gjatë mandatit tim dhe punët të cilat janë kryer gjatë mandatit tim, e kam thënë disa herë që vetëm duhet të duartrokiten dhe të përgëzohen të gjitha ato punë të cilat janë bërë, sepse në të kaluarën as që është përmendur Drejtoria e Pronës dhe Katastrit. As që janë përmendur tema të mëdha të regjistrimeve të lokaleve dhe banesave të shpronësimeve dhe gjërave tjera të cilat janë bërë në drejtorinë time.

Urim Suka - kur adresohen shqetësimet me fakte, nuk është film por është mirë ju me marrë si të mirëqen dhe me përmirësu. Kur dëgjova Azizin dhe asambleistët tjerë duke bërë propozime, mu kujtua ajo seanca e jashtëzakonshme e 2 tetorit kur i kanë bërë këta asambleistat propozimet e tyre dhe kurrë nuk kanë hyrë në buxhet. Uroj që këto propozime të sotit mos ta kenë atë fat.

Armend Krasniqi - sa i përket aparatit, nëse ka ndodhur prishja e aparatit të cilën e kemi pas në drejtorinë tonë, nuk ka ndodhur që asnjë parcelë që mos të matet për interesa të qytetarëve. Këtu kemi gjetur koncenzen koncenzen të përbashkët me gjeodetët e Suharekës dhe në Bllacë është matur dy herë parcela.

Jehona Rrafshi Lumi - uroj që mos ta kemi fatin e njëjtë sikur vitin e kaluar me propozimet tona. Unë prita nga kolegu Aziz për rrugën „Hamdi Beqa“ në Nishor të cilën e kemi diskutu disa herë dhe e cila as nuk është as nuk është në propozim dhe as nuk është e përfshirë në planifikimin e buxhetit. Sugjeroj që kjo të jetë shtesë në planifikim. Gjithëashtu edhe renovimi i rrugës „Rrafshi“ në Duhël dhe rruga „Albanika“ në Bllacë.

Alban Berisha - jam deklaruar disa herë te buxheti që nuk është në sferën time dhe ndoshta nuk marrë pjesë në këto debate por karakteristikë e këtyre viteve prej kur jam asambleist, është që shumë shpesh shoh projekt-vendime që vijnë te ne nganjëherë me dëshirën për me kalu prej anës së sponsorizuesit por shumë shpesh edhe prej dëshirës për mos me kalu. Te projekt-buxheti dhe shumë dokumente tjera që vijnë, aq arrogancë politike ka, unë nuk e kuptoj nganjëherë edhe rolin tonë si asambleist që jemi. Bëhen propozime dhe ti merr shënime. Dua të di se mbas atyre shënimeve që i merr, çka bëhet?

Unë sa e di, sikur të ishte draft-dokument shumë i kisha kuptuar propozimet e atyre kolegëve por ky është projekt-vendim dhe në moment që votohet sot, këtij dokumenti nuk guxon më me i mungu asnjë presje sepse e merr formën e prerë nga ne dhe nuk e di se si kanë me hyrë këto propozime. Ti përmende që jemi për bashkëpunim, por i ka humb vlera dhe efekti fjalës bashkëpunim. Katër herë ka ardhë kërkesa këtu për miratimin e vendimit për bonus-zonimin dhe katër herë ju kemi ofruar bashkëpunim por gjithmonë keni shkuar në stilin merre ose leje, dhe kjo leje me nënkuptuar që ju keni prurë shumë shpesh vendime me qëllim që mos me kalu. Nga fillimi është bërë politikë e njëjtë. Dua të di Kryesues, a je duke

na bë thirrje me kalu këtë apo jo?Drejtoret përkatës duhet të na japin përgjigje ndonjëherë kur kemi vërejtje.Edhe nga Drejtori i Financave kisha pas dëshir me pas një elaborim.

Kryesuesi - normal që unë bëj thirrje me votu buxhetin sepse ky nuk është buxhet i një subjekti politikë por është buxhet i qytetarëve.Bëj thirrje ta votoni dhe duhet ta votoni këtë buxhet.Sa i përket vendimit që ka ardhë dhe se si do ti fusim propozimet,normal që do të shkoj me ndryshime sepse unë do ta hedh në votim me këto propozime dhe nëse e merr miratimin,propozimet inkorporohen.

Labinot Halitjaha - sa i përket buxhetit,e mira është për me kalu sepse çdo Kryetar që vjen, asamble,ekzekutiv,në pjesën e ardhshme shumë më të lehtë ka me pas mundësinë e punës dhe të shpenzimit të buxhetit.Unë kam qenë pothuaj se në të gjitha dëgjimet publike për buxhet ,i kemi të gjitha procesverbalet si në KAB edhe në pjesën e qarkores dhe në fund kur kam dasht ti përshkruaj të gjitha kërkesat e qytetarëve,më kanë thënë që janë të shkruara në buxhet.E kam pa një lshim të madh prej pozitës,që edhe ne kemi qenë pozitë dhe jo një bashkëpunim të mirë dhe pastaj unë më nuk jam marrë me këtë punë.Ne e kemi pas një kërkesë,si prej opozitës,prej LDK-së dhe VV-së por edhe Dardani ka bë një kërkesë për heqjen e taksave komunale,dhe unë si drejtor kam pas vullnet sepse pothuaj gati në të gjitha komunat është heq,por nuk kanë pas vullnet bashkëpunimi.Ata që e kanë përfunduar procesin e buxhetimit me përshkrim,do ta përfundojnë deri në fund dhe për këtë punë s'ka mundësi edhe me kalu sepse mungon çdo send.

Laureta Tafaj - drejtor,nëse kjo ka ndodh,çka ju ka mbajtur ende në atë pozitë që jeni?Pse nuk keni dhënë dorëheqje?Pse po bashkëpunoni ende me Kryetarin në shkuarje?

Labinot Halitjaha - diskutimi yt është pothuaj real por Kryetari në debate televizive e ka caktuar që e kemi bë një marrëveshje,andaq do të jemi të sigurtë dhe do të rrimë deri në fund ne si parti.

Shefket Kolgeci - sa i përket çështjes së taksës komunale,ju e keni nis tash por kjo ka filluar para 6 viteve.Ne si grup parlamentar e kemi inicuar,ju na keni anashkaluar,na keni mbivotuar,na keni nënqmu në formë të ndryshme dhe edhe këtë mandat 2-3 herë kemi marrë iniciativë pasi pothuaj në asnjë komunë nuk ka taksë komunale.Herën e fundit PDK e solli një kërkesë dhe nuk është miratuar.Kur nuk ju kanë miratuar propozimin tuaj,unë kisha dal prej bashkëqeverisjes por ky është vendimi juaj.

Dardan Berisha - sa i përket diskutimit të fundit është jashtëzakonisht shqetësuese se si në seancën e fundit keqpërdoret foltorja për me marrë një votë në Asamble,sepse qytetarët na njohin të gjithëve.

PDK ka organet e saja të brendshme të partisë dhe nuk kemi asnjë vendim as prej qendrës dhe kështu në 30 komuna PDK bashkëqeveris.Është një vendim prej këshillit drejtues të PDK-së në qendër,që ku bashkëqeverisë me VV-në,me shpëput bashkëqeverisjen,siq ka ndodh në Gjilan dhe disa qendra tjera.Pra ne nuk kemi asnjë vendim prej këshillit drejtues i cili është organi më i lartë brenda një subjekti politik,që duhet me shpëput qeverisjen.Nuk shpëputet bashkëqeverisja pse nuk ta ka ndëgjuar një vendim,dëshirë ose një propozim.Tema është për buxhet dhe në buxhet ka disa gabime të cilat janë vazhdu dhe qëndrimi jonë ka mu mundu me qenë konstruktiv.Labinot Halitjaha dhe Armend Krasniqi kanë qenë konstruktiv dhe janë mundu me dhënë maksimumim. Nuk e them unë por e kemi thënë të gjithë,e kanë thënë raportet ndërkombëtare që kanë qenë jashtëzakonisht konstruktiv në vendimet që janë marrë brenda kuvendit dhe ekzekutivit.Ne jemi këta.Ne punojmë drejtë dhe ndershëm.

Shefket Kolgeci - nuk thashë ju me dhënë dorëheqje por unë si LDK në momentin kur një bashkëqeverisje nuk i përfill vendimet e një partie,unë nuk e kisha vazhdu bashkëpunimin.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë me propozimet e Aziz Bytyqit,Saranda Bajraktarit dhe Jehona Rrafshit.

11 për,18 kundër,1apstenim,Nuk Miratohet pika2

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të punës për periudhën 2022-2025;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe fjalën ia jep Kryesueses së grupit të grave.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përfaqësimi i grave në vendimmarrje është themelor për një demokraci funksionale,gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.Roli i grave në vendimmarrje nuk është vetëm simbolik,ai është thelbësor për hartimin e politikave që reflektojnë realisht nevojat,përvojat dhe aspiratat e gjithë qytetarëve.Përmes pjesëmarrjes aktive,gratë kontribuojnë në ndërtimin e institucioneve më të ndjeshme ndaj çështjeve sociale,barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.Ky raport përmbledh punën 4 vjeqare të Grupit të grave të Kuvendit komunal të Suharekës gjatë mandatit 2022-2025.Ai ka për qëllim të ofroj një pasqyrë të angazhimeve tona,iniciativave të ndërmarra,sfidave të hasura dhe ndikimit të

drejtëpërdrejtë në përmirësimin e jetës së grave dhe komunitetit tonë. Raporti synon të forcojë kulturën e llogaridhënies publike dhe të shërbejë si një dokument referues për grupet e grave që do të vijnë në të ardhmen. Gjatë këtij mandati grupi i grave ka luajtur një rol të rëndësishëm në avokimin për barazi gjinore, fuqizimin e grave në jetën publike dhe mbështetjen e iniciativave që prekin drejtëpërdrejtë mirëqenien e qytetarëve të komunës tonë. Në bashkëpunim të ngushtë me zyrtaren për Barazi Gjinore znj. Habibe Bytyqi dhe me Nënkryetarene Komunës znj. Mihrije Suka kemi ndërtuar ura bashkëpunimi dhe kemi krijuar hapësira më të mëdha për përfshirjen e grave në procese vendimmarrëse. Grupi i grave ka qenë aktiv dhe i përfaqësuar në shumë takime të organizuara nga organizatat jo qeveritare dhe institucionet që synojnë rritëzimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet grupeve të grave nga komunat e ndryshme të Kosovës. Të arriturat dhe funksionimi i grupit është vlerësuar nga OSBE dhe është marrë si model, ku të gjitha këto janë prezantuar në konferencën vjetore të grupeve të grave në nivel të Kosovës. Në emër të grupit të grave ju falemnderoj për bashkëpunimin juve si legjislativ por edhe si ekzekutiv sepse të gjitha të arriturat që janë të pasqyruara në këtë raport, të gjitha organizimet, të gjitha projekt-vendimet që janë inicuar nga ky grup, kanë pas frymën bashkëpunimi nga secili anëtar i këtij kuvendi dhe vetëm përmes frymës bashkëpunuese që e kemi pas këto katër vite, kemi arrit me fuqizu rolin e gruas në komunën tonë.

Kryesuesi - ju përgëzoj për punën që e keni bërë si grup i grave. E hap debatin.

Urim Suka - unë në emër të grupit të LDK-së e përshëndes grupin e grave për punën që e kanë bërë për periudhën 4 vjeqare, për raportin që tash e kemi në dorë dhe mund të shërbejë edhe për periudhën e ardhshme, në asamblenë e ardhshme. Duke marrë për bazë situatën edhe ndoshta pabarazinë që ndoshta ende ekziston në vende të caktuara, ky grup i grave inkurajoj që me funksionin edhe në Asamblenë e ardhshme dhe me propozim vendime të rëndësishme që i mbrojnë të drejtat e njeriut, të drejtat e grave dhe që promovojnë demokracinë dhe bashkëpunim në të ardhmen. Jemi për me i mbështetë çdo ide që vjen nga ky grup.

Pika 4. Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - kam një shqetësim që e kam marrë nga një qytetar, Halit Aliaj i cili ka deponuar një kërkesë në komunë. Të njëjtit iu ka djeg stalla me gjithë pasurinë që e kanë krijuar me shumë sakrificë e mund. Ne e kemi pa Kryetarin duke shkuar me do dushka, duke bërë filma por sot ka ardhë koha me mbështetë atë. Dua të di pse nuk ka ardhë kjo pikë ashtu sikurse i kemi përkrah edhe palët tjera që janë dëmtuar, çoftë prej zjarrit e çoftë prej gjërave tjera?

Nënkryetarija - nuk më duket e drejtë me thanë që kryetari po bën filma sepse këto janë fatkeqësi natyrore që ndodhin gjithkund dhe nuk besoj që dikush shkon me bo filma apo skena. Sa i përket mbështetjes së personit që është dëmtuar, edhe ky rast do të ishte ndihmuar mirëpo në mungesë të mjeteve dhe për shkak të pamundësisë sepse janë marrë shumë mjete edhe te investimet kapitale, edhe te subvencionet, edhe tek mallra dhe shërbime, andaj Komuna nuk ka mundësi për momentin dhe ndoshta do të gjindet mundësia deri në fund dhe shpresojmë që të kompenzohet.

Urim Suka - në fillim të vitit shkollor e di që ka pas vonesa në rekrutimin e mësimitdhënësve dhe si pasojë ka pas një numër të madh të orëve të humbura dhe përveq asaj është një numër i kandidatëve që janë në Asamble që punojnë edhe në arsim dhe tash në fushatën zgjedhore nuk u lejohet të japin mësim. Dua të di çka po ndodh me fëmijët? A po humbin orë të tjera dhe çka mund të bëjë drejtori për me i zëvendësuar?

Kryesuesi - nuk besoj që nuk është bërë ndonjë zgjidhja sepse një muaj është shumë humbje mirëpo nuk e di situatën se si është.

Urim Suka - disa informata që i kam, e di që janë duke humbur orë dhe për këtë e ngrita si shqetësim.

Doruntina Zenelaj - një familje e dëshmorëve dëshiron të informohet se çfarë ka ndodh me banesat që kanë pas për tu dhënë për familjet e dëshmorëve. A i kanë dhënë dhe nëse po, kush i ka marrë?

Kryesuesi - e di që komisioni ka punuar dhe a e ka marrë formën përfundimtare, nuk e di.

Nënkryetarija - edhe për mua ndoshta do të jetë seanca e fundit që jam e pranishme. Ju falemnderoj gjithësecilin për respektin ndaj meje si Nënkryetare. Unë jam mundu me qenë bashkëpunëtor me të gjithë dhe sigurisht mandatin tjetër nuk do të jem por juve ju uroj suksese të gjithëve.

Takimi përfundoi: 11:15

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj